




FEMART FESTIVAL
ME LIRI KUNDËR MARRES
FREEDOM VS SHAME

EDICIONI / EDITION 7
10-16.06.2019





FEMART FESTIVAL
ME LIRI KUNDËR MARRES
FREEDOM VS SHAME

EDICIONI / EDITION 7
10-16.06.2019

PËRMBAJTJA

GRAND HAPJA	10
EKSPOZITA - "BËHU FYTYRA IME" Kosovë	12
PERFORMANCË - PAS ASAJ Kosovë	14
KONCERT - LUBICELA "NË NDER TË CESARIA EVORA" Afrikë & Portugali	16
KONFERENCË - #EPATHYER / Vendi i gabuar, koha e gabuar - 20 vjet pas	18
MASTERKLASË - GRATË NË WIKIPEDIA + EDIT-A-THON	19
MBREMJE POETIKE DHE MUZIKË - "POEZI PËR FUQI"	20
QUEENDOM Hungari	24
KONFERENCA - #EPATHYER - SHFUQIZIMI I MARRES DHE PREZANTIMI I RAPORTIT "Aborti në Kosovë, një analizë e aborteve të detyruara dhe shëndeti riprodhues 1999-2019"	26
INAUGRIMI I MURALIT - #EPATHYER PROMOVIMI DHE FUQIZIMI I GRUAS PËRMES ARTIT" Holandë	28
SHFAQJA TEATRALE "ETYMOS" Itali	29
NDEJË – LIKWUID / usa WARM UP - LILAC / ks	30
PUNËTORI – "KRIJIMI I POSTERAVE FEMINIST" SHQIPËRI, ITALI	31
PREZANTIM: "BISEDË ME SILVIA BASSO: ILUSTRIMI, GJUHA DHE INOVACIONI	33
PUNËTORI – "BËHU RITMI" YEMADAS PORTUGALI	34
PANEL DISKUTIMI "GRATË ARTISTE NË VENDIMMARRJE"	35
SHFAQJA TEATRALE "LA GRAND CAHIER" Japoni	36
AKTIVITETI - "KYQU + ANGAZHOTHU + FRYMËZOHU"	38
PUNËTORI - "BËHU RITMI IM" YEMADAS Portugali	40
EKSPOZITË SHITËSE - "ZAMBAKU I LUGINËS" & MUZIKË Kosovë	41
SHFAQJE TEATRALE "KANUNI I GRUAS" PREMIERË Kosovë	42
PANEL DISKUTIMI "PROMOVUESET E REJA TË PAQES NGA RAJONI" / DISKUTIM REGJIONAL	44
PROMOVIM LIBRI & PANEL DISKUTIMI - "DIALOGU NDËRGJENERAT MBI AKTIVIZMIN FEMINIST NË ISH-JUGOSLLAVI"	45
SHFAQJE TEATRALE - UDHA E QUMËSHTIT - Shqipëri	46
PERFORMANCË ARTISTIKE & SLAM POEZI - "NGA 'TJETRI' TE 'VETJA Kosovë	48
FEMART FINALE - KONCERT Portugali, Shqipëri, Kosovë	49

CONTENT

GRAND OPENING	10
EXHIBITION "BE MY FACE" Kosovo	13
PERFORMANCE - AFTER THAT... Kosovo	14
CONCERT - LUICIBELA "TRIBUTE TO CESARIA EVORA" Africa & Portugal	16
CONFERENCE "#UNBROKEN / Wrong Place, Wrong Time - 20 Years Later"	18
MASTERCLASS - WIKIWOMEN +EDIT-A-THON	19
POETRY NIGHT & MUSIC "POETRY FOR POWER"	22
QUEENDOM Hungary	25
CONFERENCE – UNBROKEN / BREAKING THE POWER OF SHAME AND PRESENTATION OF REPORT "Abortions in Kosovo: an analysis of induced abortions and reproductive health from 1999-2019"	26
INAUGURATION OF MURAL "#UNBROKEN - PROMOTING AND EMPOWERING WOMEN THROUGH ART Netherland	28
THEATER PERFORMANCE "ETYMOS" Italy	29
AFTER PARTY - LIKWUID / usa WARM UP - LILAC / ks	30
WORKSHOP – CREATING FEMINIST POSTERS Albania, Italy	32
PRESENTATION: "TALK WITH SILVIA BASSO: ILLUSTRATION, LANGUAGE AND INVENTION" Italy	33
WORKSHOP – "BE THE RHYTHM" YEMADAS Portugal	34
PANEL DISCUSSION "WOMEN ARTISTS IN DECISION-MAKING"	35
THEATER PERFORMANCE "LA GRAND CAHIER" Japan	36
ACTIVITY - "CONNECT + ENGAGE + INSPIRE"	38
WORKSHOP – "BE THE RHYTHM" YEMADAS Portugal	40
"LILY OF THE VALLEY" – SALES EXHIBITION AND MUSIC	41
THEATER PERFORMANCE "WOMEN'S KANUN" PREMIERE Kosovo	42
PANEL DISCUSSION "YOUNG PEACE PROMOTERS FROM REGION" / REGIONAL DISCUSSION	44
BOOK PROMOTION & PANEL DISCUSSION "INTERGENERATIONAL DIALOGUE ON FEMINIST ACTIVISM IN NATIONAL POST YUGOSLAV SPACE"	45
THEATER PERFORMANCE "MILKY WAY" / Albania	46
ARTISTIC PERFORMANCE & SLAM POETRY "FROM 'OTHER' TO 'SELF'" Kosovo	48
FEMART FINALE - CONCERT Portugal, Albania, Kosovo	49



**Përshëndetje nga Drejtoresha
e festivalit FemArt,
Zana Hoxha Krasniqi**

Të dashura artiste, aktiviste, miq dhe përkrahës të Festivalit FemArt, faleminderit që keni zgjedhur të bëheni pjesë e aventurës sonë të artit të angazhuar feminist gjatë 10-16 Qershor, 2019.

Në edicionin e 7-të të festivalit FemArt për 7 ditë dhe me mbi 30 ngjarje do të dëgjohen zërat e 200 artisteve, të cilat prezentohen me shfaqje teatrale, koncerte, promovime librash, ekspozita, poezi, punëtori, panele diskutimi, mural dhe forma tjera të artit.

Gjatë një jave të mbushur me krijime artistike të cilësisë së lartë, energji pozitive, fuqi e mbështetje të pafundme, FemArt do të vendosë rregullat e lojës, duke u angazhuar të rrisë vetëdijen dhe të fuqizojë gratë pa marrë parasysh përkatësinë etnike, sociale, raciale apo preferencat seksuale.

FemArt ngre zërin për të gjithë ato dhe ata që për ndonjë arsye ose tjetër nuk mund të flasin për veten, nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre njerëzore, të jetojnë në liri e në paqe me dinjitet të pacenushëm nga normat shoqërore që i shërbejnë "shtypësve". Përkundër rrahjeve nga çdo sfidë që shoqëria patriarkale sjellë, gratë vazhdojnë të jenë shtylla kërkuese "me liri kundër marres".

Ne do të ngrejmë zërin bashkarisht me gratë që duan të jenë pronare të jetës së tyre, të marrin vendime pa hezituar, të dalin nga guacka ku janë strukur me forcë, të frikësuara nga paragjykimet e mendësia patriarkale që gjykon, përbuz, stigmatizon, dhunon e vret.

Me lirinë e lojës teatrale, të magjisë së fjalës, të ngjyrave të veçanta, të muzikës magjepsëse, poezive të guximshme do të ngremë zërin për ato që ngurojnë për tu shprehur, që nuk mund të dëgjohen, e të angazhohemi së bashku për të drejtat e njeriut, të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues,

paqen dhe drejtësinë tranzicionale, të drejtat e komunitetit LGBTQI, fuqizimin e grave dhe vajzave, shkëmbimin e përvojave të suksesshme në rajon dhe në botë, dhunën në baza gjinore e shumë çështje të tjera jetike me të cilat përballen gratë dhe vajzat në Kosovës e kudo në botë.

Organizimi i kësaj jave artistike dhe aktiviste është mundësuar nga angazhimi i pakursyer i Stafit të Qendrës Artpolis dhe me mbështetjen e pakusht të donatorëve: Bashkimi Europian, Kvinna till Kvinna, Austrian Development Cooperation, UNFPA, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Prishtinës / Iniciativa 20/20, Cfd, Unë e Du Kosovën, UNWOMEN, IPKO Foundation, Koalicioni K10, Hotel International Prishtina, pastaj përkrahësit institucional dhe medial: Glam Radio, Biblioteka Kombëtare e Kosovës- "Pjetër Bogdani", Muzeu i Kosovës, Teatri Oda, KultPlus, të cilët i falenderoj nga zemra për partneritetin e vazhdueshëm.

Të dashur miq, të dashura artiste e aktiviste, vullnetarë, përkrahës, donatorë e mbështetës fisnik të kauzës sonë, ju që besoni se ndryshimi është i mundur, ju ftoj të na bashkoheni e të bëheni pjesë e këtyre aktivitete .

Ju presim, FemArt ka zë dhe do të dëgjohe!

Zana Hoxha Krasniqi
Drejtoreshë e festivalit

Foreword by Zana Hoxha Krasniqi, FemArt Festival Director

Dear artists, activists, friends and supporters of FemArt Festival. Thank you for choosing to be part of our adventure of feminist engaged art from 10 - 16 June 2019.

During the seven days of the FemArt Festival and with over 30 events, the seventh edition of the Festival will bring forth the voices of 200 artists, performing theater plays, concerts, book promotions, exhibitions, poetry, workshops, discussion panels, murals and other forms of art.

During a week filled with high quality artistic creations, positive energy, enormous power and support, FemArt will set the rules of the game by trying to raise awareness and empower women regardless of their ethnic, social, and racial background, and sexual preferences.

FemArt raises the voice on behalf of all those who for one reason or another cannot speak for themselves, cannot exercise their human rights, cannot live in freedom and peace with inviolable dignity from the social norms that serve the 'oppressors'. Despite the beatings from every challenge imposed by the patriarchal society, women continue to be the demanding pillar "with freedom vs shame."

We will raise our voice together with women who want to own their lives, to take decisions with no hesitation, to come out of the shell where they have been put against their will, frightened by the patriarchal prejudice and mindset that judges, despises, stigmatizes, abuses and kills.

With the freedom brought by the theater plays, magic of the word, of the special colors, of enchanting music, courageous poetry, we are going to raise our voice on behalf of those who hesitate to speak up, who cannot be heard. Let us jointly work towards human rights, sexual and reproductive health rights, peace and transitional justice, LGBTIQI community's rights, empowerment of women and girls. Let's exchange successful experiences in the region and the world; let's talk about gender-based violence, and many other vital issues that women and girls in Kosovo and all over the world face.

This artistic and activism week was organized and enabled by the generous engagement of the staff of Artpolis Center, and unreserved support of the following donors: European Union, Kvinna till Kvinna, Austrian Development Cooperation, UNFPA, Ministry of Culture, Youth and Sport, Municipality of Prishtina, 20/20 Initiative, Cfd, I Love Kosovo [Unë e Du Kosovën], UNWOMEN, IPKO Foundation, K10 Coalition, Hotel International Prishtina, including institutional and media supporters: Glam Radio, "Pjetër Bogdani" National Library of Kosovo, Museum of Kosovo, Oda Theater, KultPlus, whom I would like to thank profoundly for the continuous partnership.

Dear friends, dear artists, activists, volunteers, supporters, donors and noble supporters of our cause, you who believe that change is possible: come and join us and be a part of these activities. We look forward to see you there! FemArt has a voice and will be heard!

Zana Hoxha Krasniqi
Festival Director



FEMART FESTIVAL ME LIRI KUNDËR MARRES

**EDICIONI 7
10-16 QERSHOR 2019**

Për herë të shtatë, Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis organizon festivalin FemArt – Festivalin ndërkombëtar të artisteve dhe aktivisteve, që do të mbahet në Prishtinë gjatë datave 10-16 Qershor, 2019 (7 ditë). Në gjashtë edicionet e kaluara, festivali i parë feminist që mbahet në Kosovë "FemArt", ka arritur të përmbushë qëllimin e tij për të krijuar një atmosferë ku Artistet ndihen të mirëpritura për ta shfaqur artin e tyre, i cili burimin e frymëzimit e ka pasur nga temat shoqërore dhe të drejtat e njeriut në Ballkan. Krahas kësaj, "FemArt" shumë shpejt është bërë një platformë dinamike sa i përket aktiviteteve, përmes të cilave publiku vazhdon të mësojë për problemet shoqërore me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat e Kosovës, madje festivali ka shkuar përtej kësaj, duke prekur dhe problemet e grave dhe artisteve në rajon dhe botë, duke përfshirë zërat dhe perspektivat e artisteve nga shumë vende të botës. Vec kësaj, festivali përveç që pasqyron këto probleme, përmes formave të ndryshme artistike, paneleve e diskutimeve shpallorë edhe rrugët që duhet ndjekur për të tejkaluar këto probleme, shpesh duke i përdorur rastet individuale si përjetime të përbashkëta shoqërore.

Moto e festivalit këtë vit është "Me Liri kundër Marres", përmes së cilës inkurajohen gratë të drejtojnë vet timonin e jetës së tyre dhe të marrin në duart e tyre vendim-marrjen, duke promovuar një jetë pa paragjykime e gjykime. Në një mjedis ku dominon mendësia patriarkale, gratë vazhdimisht gjykojnë dhe turpërohen për çfarëdo arsyje e veprimi. Prandaj, mbi bazën e kësaj motoje, ne kemi për qëllim të rrisim vetëdijen dhe të fuqizojmë gratë pa marrë parasysh përkatësinë etnike, sociale, raciale apo preferencat seksuale.

Festivali përdoret si një platformë për iniciimin dhe paraqitjen e ideve dhe krijimeve që sjellin

përpara konceptet feministe dhe zhvillimin e tyre në Kosovë, si dhe avokimin e të drejtave të barabarta dhe ndërtimin e paqes në rajon. Festivali do të bashkojë mbi 200 artiste dhe aktiviste nga vendi, rajoni dhe bota të cilat vijnë me nivele të ndryshme të përvojës, nga ato që performojnë për herë të parë, deri tek profesionistët me shumë përvojë. FemArti do të vazhdojë të qëndrojë besnik synimeve të tij duke krijuar një hapësirë të përbashkët, ku bashkohen veçantitë artistike të grave që besojnë në barazinë gjinore. Ato në FemArt vijnë duke bartur një copëze historie nga vendi i tyre përmes gjuhës universale të artit dhe kështu duke bërë Kosovën një vend ku për disa ditë radhazi ndeshen përvojat e grave që duan të sundojnë veten dhe të besojnë në rolin dhe kontributin që mund të japin shoqërisë.

Festivali do ketë krijime artistike origjinale të fusheve të ndryshme, të krijuara nga gra dhe vajza të rajonit. Arti i tyre do të paraqitet në medime e forma të ndryshme artistike si: shfaqje teatrale koncerte, promovime librash, modë, art performues, instalacione arti, poezi, punëtori, panele diskutimi, art urban dhe forma tjera të artit.

Festivali do të zhvillohet mbi bazën e temave që lidhen me të drejtat e njeriut, të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, paqen dhe drejtësinë tranzicionale, të drejtat LGBTQI, fuqizimin e grave dhe vajzave, shkëmbimin e përvojave të suksesshme në rajon dhe në botë, si dhe për dhunën në baza gjinore e shumë çështje të tjera.

Audienca është ajo që e përforcon edhe më shumë dinamikën që bart festivali. Gjatë edicioneve të kaluara, festivali arriti të mbledhë një audience të madhe, të cilët tashmë janë shndërruar në miq besnik të festivalit dhe në pjesë interaktive të tij. Në 6 edicionet e kaluara Festivalit ka gëzuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të mbi 1200 njerëzve/artisteve/aktivisteve, më shumë se 20,000 shikues, dhe mbi 300 raporte mediale (të shkruara, në portale, dhe televizion) të publikuara në Kosovë dhe rajon.



FEMART FESTIVAL FREEDOM VS SHAME

**7th EDITION
10-16 JUNE 2019**

For the seventh time, Art and Community Center - Artpolis will organize FemArt Festival - Women Artists and Activists Regional Festival is to be held in Prishtina from 10-16 June, 2019 (7 days). During the past six editions, the first feminist regional festival in Kosovo "FemArt" achieved its mission of providing a welcoming place for women artists to show their art, inspired by social themes and human rights in the Balkans. FemArt has quickly become a dynamic platform of activities enabling the public to learn about social problems that women and girls in Kosovo face. In fact, the Festival went beyond that by exposing problems of women and artists in the region and the world, including providing a platform where the voices and perspectives of women artists from many countries of the world are heard. Also, this Festival not only reveals these problems, through different artistic forms, discussions and panels, it also reveals paths that one must follow to overcome these problems, often by using individual cases as joint social experiences.

This year's Festival motto "Freedom VS Shame" encourages women to take ownership of their lives and decision-making while promoting a life free of judgment and prejudice. In a society where patriarchal mindset prevails, women are constantly judged and shamed for whatever reason and action. Thus, with this motto we aim to raise awareness and empower all women regardless of their ethnic, social, racial backgrounds and sexual preferences.

The Festival is used as a platform for initiating and presenting ideas and creations that bring

ahead the feminist concepts and its developments in Kosovo and advocate for equal rights and peace building in the region. The Festival will bring together over 200 local, regional and world women artists and activists of all experience levels, from first time performers to experienced professionals. FemArt will stay loyal to its goals by creating a common space that brings together women artists' features who believe in gender equality. They bring to FemArt a piece of their country's history through the universal language of art, thus making Kosovo a country which for several days in a row will encounter experiences of women who want to rule themselves and to believe in the role and contribution they could give to the society.

The Festival will feature original artistic creations created by women and girls of the region. Their art will be shown using various artistic mediums and forms, such as: theater plays, concerts, book promotions, fashion, performing arts, art installations, poetry, workshops, panel discussions, street art and other forms of art.

The program will include, but not limit to topics, such as: Human Rights, Sexual and Reproductive Health Rights, Transitional Justice and Peace, LGBTQI Rights, Women and Girls Empowerment, Violence against Women, Gender-based Violence, Global and Regional Exchange success stories, etc.

Audience is what strengthens more the dynamics of this Festival. During the past editions, the Festival achieved to attract a large number of audiences, who have already become loyal friends of the Festival and an interactive part of it. During the past six editions, there were more than 1200 people/artists/activists participating in the Festival, with more than 20,000 viewers and over 300 reports (print and online articles, and TV stories) published in Kosovo and the region.

GRAND HAPJA
GRAND OPENING



PRITJA E MYSAFIRËVE WELCOMING GUESTS

"HOTELI "GRAND", është vendtakimi i parë i **FemArtit** me mysafirët e saj. Ky objekt që dikur gëzonte nam të madh, sidomos para luftës në Kosovë pasi që aty kërret më të mëdhenj shtetëror kanë gjetur shërbimin dhe akomodimin e klasit botëror. Në njërin kat të këtij hoteli qëndronte vazhdimisht edhe lideri jugosllav Josip Broz Tito. Megjithatë, tanimë ky hotel duke si i neglizhuar, përkundër potencialit për zhvillim dhe mundësisë për ti dhënë namin që kishte dikur. Hotel Grand që është një nga ndërtesat e para sapo del ne qendër të qytetit, kërkon vëmendje, në mënyrë që pesha e tij të mos matet vetëm me të kaluarën.

GRAND HOTEL is the first meeting point of FemArt with its guests. This building used to be famous, especially before the war in Kosovo because it used to host the highest state leaders, and it offered world class service and accommodation. Yugoslav leader, Josip Broz Tito, used to stay in one of the floors of the hotel whenever he was in town. However, it seems that this hotel is now neglected despite its potential for development and opportunity to restore its past reputation. Grand Hotel is one of the first buildings that people encounter once they are stepping out in the city center; it seeks attention so that its weight is not measured by the past only.

EKSPOZITA "BËHU FYTYRA IME" Kosovë

📍 10.06.2019 - DITA E PARË (E HËNË)

🕒 20:15 - 21:30

📅 HOTEL GRAND

EKSPOZITË

kuratore: ELIZA HOXHA

Vasfije Krasniqi – Goodman është zëri i parë i të mbijetuarave të përdhunimit seksual, që përjetimin e saj e ka shprehur publikisht. Tregime të tjera të strukura në heshtjen e kufizuar me paragjykime, tentojnë ti thyejnë këto kufizime duke ardhur sa më pranë publikut përmes ekspozitës së Eliza Hoxhës.

"Bëhu fytyra ime" synon të sjellë pjesë të këtyre tregimeve si deklarata në korniza boshe të varura në një ekspozitë përmes së cilës vizitorët ftohen për t'i përfytyruar këto tregime si përjetime të tyre, duke u përballur me pyetjet: Çfarë do të ndodhte nëse ky do të ishte rrefimi juaj? Cili do të ishte dënimi apo reagimi yt ose a cila është historia që mund ta përfaqësoni ju?

Kjo është një ekspozitë interaktive ku vizitorët mund të zgjedhin kornizën e tyre dhe të përballen me një deklaratë ose histori të të mbijetuarave seksuale. Përballja me këtë realitet nuk është misioni i vetëm i ekspozitës, e cila në thelb tenton fuqizimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së Kosovës, pra duke e mposhtur turpin dhe paragjykimet dhe duke i kthyer në dëshmitare të një pjesë të trishtë të historisë së luftës.

Jo rastësisht ky objekt (Grand Hotel), bartës i historisë së trishtuar dhe vatër i krimeve gjatë konfliktit në Kosovë, do ta ofrojë hapësirën e vet për të hapur festivalin FemArt, përmes **ekspozitës** shumë të veçantë të artistes së dëshmuar e shumëdimensionale që ka përfaqësuar pavionin e Kosovës në Bienalen e Venedikut të vitit 2018 dhe ka përdorur artin për të prekur dhe avokuar historitë e të mbijetuarve të luftës. Në FemArt, **Eliza Hoxha** përmes ekspozitës **"Be my Face"** shpalosë një dimension sa artistik, aq dhe human.

Janë se paku 20 skica me 20 deklarata të ekspozitës që do të ju përballin me histori rrëqethese, si reflektim për tu bashkuar me forcën në tejkalimin e tyre duke i kthyer në histori të përbashkët.



Eliza Hoxha është arkitekte me profesion, por e njohur poashtu edhe për punët e saj në art, muzikë, fotografi, shkrime dhe kurim. Ajo ishte pjesë e shumë ekspozitave kolektive, përdërisa nga ekspozitat personale për tu veçuar janë ato të lidhura me çështjet të komuniteteve në Kosovë, si ekspozita multimediale në Galerinë Kombëtare të Kosovës në vitin 2007 dedikuar personave të pagjetur gjatë luftës në Kosovë, poashtu ekspozita kushtuar grave të abuzuara seksualisht gjatë luftës, ekspozitë kjo që është mbajtur në Muzeun Kombëtar të Kosovës në vitin 2014. Ajo u ndërrua me Çmimin për **"Promovim të Arkitekturës"** nga Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës në vitin 2011. Një tjetër çmim që e vlerësoi Hoxhan ambasadore të mjedisit në Kosovë erdhi nga lëvizja BELLS në vitin 2011 dhe një tjetër nga Rrjeti i Grave të Kosovës në vitin 2013 për promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave në Kosovë. Përgjatë viteve 2011-2015 ishte president e Këshillit Drejtues të Galerisë Kombëtare të Kosovës. Ajo është anëtare e Parlamentit Kulturor Evropian. Dy nga punët/fotografitë e saj tani janë pjesë e koleksionit të Muzeut Kombëtar të Grave në Art në Ëashington. DC që nga prilli i vitit 2016. Ajo ishte përfaqësuese e Pavijonit të Kosovës në edicionin e 16-të të **Bienales së Venedikut** për Arkitekturë, në vitin 2018 në Itali. Së fundi ishte kuratore e ekspozitës "Të jetosh me kujtimet e të pagjeturve", e cila u kushtohet familjarëve të të pagjeturve në Kosovë nga lufta e fundit dhe që është ekspozuar në hapësirat e Parlamentit të Kosovës në shkurt të vitit 2019, fuqizuar nga Integra. Ekspozita e njejte ishte edhe në **Kongresin Amerikan** në kuadër të senances dëgjimore për viktimat e dhunës në Kosovë nga lufta e fundit që kulmoi në vitin 1999, ndërsa eventit u organizua nga Komiteti për Punë të Jashtme. Eliza Hoxha numëron një numër të madh ekspozitash personale dhe kolektive brenda dhe jashtë Kosovës.

EXHIBITION "BE MY FACE" Kosovo

📍 10.06.2019 - DAY ONE (MONDAY)

🕒 20:15 - 21:30

📅 GRAND HOTEL

EXHIBITION

Curator: ELIZA HOXHA

Vasfije Krasniqi Goodman is the first voice of the survivors of the sexual violence who has publicly revealed her story. Other stories, hidden in the silence restricted by prejudice, try to break these restrictions by coming closer to the public through Eliza Hoxha's exhibition.

"Be my face" aims to bring parts of these stories as statements in empty frames hanged in an exhibition where visitors are called to visualize these stories as if the same thing could happen to them facing the following the questions: What if this was your story? What would your punishment, reaction be or which story could represent you?

This is an interactive exhibition where visitors could choose their frame and give face to a certain statement or story of sexual violence survivors. Facing this reality is not the only mission of the exhibition, which in essence strives to empower the sexual violence survivors of the Kosovo war, by defeating the shame and prejudice, and transforming them into witnesses of a sad portion of the war history.

Not by accident, the building (Grand Hotel), as a carrier of a sad history and the seat of crimes during the conflict in Kosovo, will provide its space for the FemArt Festival opening through a very special **exhibition** of a prominent and multidimensional artist, who has represented Kosovo's Pavilion in 2018 Venice Biennale and has used her art to address the issue of war survivors and to advocate on behalf of them. At FemArt, through "Be My Face" exhibition, **Eliza Hoxha** reveals both an artistic and human dimension.

There are at least 20 frames with 20 statements of the exhibition that will make you face horrendous stories. They come as a reflection to join the force to overcome those stories and unite them into one joint story.



Eliza Hoxha is an architect by profession, but also known for her works in arts, music, photography, writing and curating. She was a part of many collective exhibitions, while her personal exhibitions to highlight are the ones linked to community issues in Kosovo, such as a multimedia exhibition in 2007 at National Gallery of Kosovo dedicated to missing persons from the war in Kosovo, and also the personal exhibition dedicated to sexually abused women at National Museum of Kosovo in 2014. She received the "Promotion of Architecture" award by the Association of Kosovar Architects in April 2011. In 2011, BELLS honored her with the title Environment Ambassador in Kosovo, while in 2013, Kosovar Women Network awarded her for her work in promoting women's and girls' rights in Kosovo. From 2011 until 2015 she was President of the Executive Board of the National Gallery of Kosovo. She is a member of ECP-European Culture Parliament. Since April 2016, two of her works/photos are now a part of the collection of National Museum of Women in Arts in Washington, DC. She represented Kosovo Pavilion at 16th Architecture Venice Biennale, 2018 - Italy. Recently she curated an exhibition "Living with the memories of the missing" dedicated to the families of missing persons in Kosovo from the last war - shown at the Kosovo Parliament in February 2019, empowered by Integra. The same exhibition was at the **U.S. Congress**, Washington DC, U.S. as a part of the special hearing session of the Foreign Committee on the victims of violence from the 1999 war in Kosovo. Eliza Hoxha has presented her work in many personal and collective exhibitions inside and outside Kosovo.

PERFORMANCË - PAS ASAJ /
PERFORMANCE - AFTER THAT...

Kosovë / Kosovo



Pas Asaj

Art Performance

Agnes Nukshiqi dhe Mjellma Goranci



Artistet/Artists: AGNES NOKSHIQI & MJELLMA GORANCI

Pas asaj.....

Ajo, një vajzë!...

Endërimtare për te ardhmën e saj, ecte lehtë në momentet e kohës...me ritëm dhe optimizmin e jetës.

Bota kishte shume ngjyra në të....priste ti zbërthente në të ardhmën.

Frikën nuk e njihte! Donte ta zbulonte botën dhe mrekullitë e saja...

Mbrëmja, era e lehtë....një muzikë e largët në shetitjen e saj....në shpirt.....kishte shumë pasion.

Artiste...e jetës së saj.

Ti? A e ke atë të drejtë?.... Kush e ka?!

Pas asaj....

Tutje....

Ajo duhet me u ngrit n'kambë!!!

Në këtë rrëfim që nis në veten e tretë vjen si një formatë i veçantë artistik i performancës që ka bërë bashkë dy artiste të njohura **Agnes Nokshiqin dhe Mjellma Gorancin**. "**Pas asaj**" sjellë një histori të plotë me ëndrra që marrin kuptim atëherë kur dorëzimi mposhet nga prioritetet tjera e nuk shihet as si hap i fundit në këtë labirinth.

After that...

She, a girl! ...

Dreamy for her future, she walked easily in moments of time... with the rhythm and optimism of life.

The world had a lot of color in it ... waiting to break into the future.

Did not recognize fear! She wanted to discover the world and its miracles

Evening, a light breeze, a distant music wandering around... So much passion in her soul.

Artist... Of her life.

You? Do you have that right? Who has it?!

After that...

Further...

She must stand up on her feet!!!

The story told on the third person is of a special artistic performance format that brought together two known women artists, Agnes Nokshiqi and Mjellma Goranci. "After that..." brings a story full of dreams that make sense only then when surrender is defeated by other priorities and is not seen neither as the last step in this labyrinth.



Agnes Nokshiqi ka lindur në vitin 1975 në Shkup të Maqedonisë Veriore.

Qysh në moshë të re, Agnes tregoi interesim për artet skenike. Ajo fillimisht u përkushtua në balet klasike ndërsa pasi ka përfunduar shkollën e mesme për muzikë dhe balet në Shkup, ajo ndoqi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve Dramatike në Shkup.

Nokshiqi përfundoi studimet e nivelit master, me shfaqjen teatrale "CIRCLE", një adaptim nga David Hare që kombinon teatër, tekst (fjalë) dhe lëvizje, duke përdorur sistemin Meyerhold. Puna e saj është e lidhur me medime të ndryshme, ku përfshihen videoklipe komerciale, filma, shfaqje dhe video live. Agnes aktualisht është ligjëruese në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës në Kosovë.

Agnes Nokshiqi was born in 1975 in Skopje, North Macedonia.

From a young age Agnes showed interest in scenic arts. She was initially into classical ballet, then she attended the Music and Ballet High School in Skopje, and continued her studies at the Faculty of Dramatic Arts in Skopje, where she studied acting.

Nokshiqi completed a master's degree with a theater performance "CIRCLE", an adaptation from David Hare that combines theater, text (word) and movement, using the Meyerhold system. Her work is related to different mediums that include commercial video clips, movies, and live video performances. Agnes is currently a teacher at Faculty of Arts, University of Prishtina, Kosovo.



Mjellma Goranci është artiste multimediale nga Kosova. Ajo filloi studimet në vitin 1998, ndërsa vite më vonë u diplomua në degën e Dizajnit Grafik, pranë Fakultetit të Arteve, në Universitetin e Prishtinës ndërsa në po këtë universitet ka përfunduar edhe studimet pasdiplomike, të nivelit master në Multimedia.

Goranci vazhdimisht ka qenë aktive në skenën e artit. Për të arti është një iluzion i bukur dhe pikërisht për këtë arsye, ai ka ngacmuar gjithmonë kureshtjen e saj dhe këtë e ka përdorur si terap në shumë fusha.

Sot Mjellma është profesorëshe e Dizajnit pranë Fakultetit të Arteve në Prishtinë, ndërsa punon edhe si skenografe në televizion publik RTK.

Mjellma Goranci is a multimedia artist from Kosovo. She started her studies in 1998 and graduated with a degree in Graphic Design from the Faculty of Arts, University of Prishtina. She also has a postgraduate degree in multimedia from the same university.

Goranci has been active in the field of art all her time. The fact that art is a beautiful illusion has always awakened her curiosity and has been used as a therapy in many areas.

Today, Mjellma is a Professor of Design at the Faculty of Arts, Prishtina, and also works as a screenwriter in the public television RTK.

KONCERT LUBICELA
"NË NDER TË CESARIA EVORA"

CONCERT - LUICIBELA
"TRIBUTE TO CESARIA EVORA"

Afrikë & Portugali / Africa & Portugal



📍 10.06.2019 – DITA E PARË/DAY ONE (E HENË/MONDAY)
🕒 21:30 - 00:00
🎫 TEATRI ODA/ODA THEATER

KONCERT/CONCERT

**Artistët/Artists: LUCIBELA; CAVAQUINHO: JOSÉ ANTONIO;
KITARË: STEPHAN GEORGE**

Mbrëmja e parë do të përfundojë me koncert nën tingujt e bukur të muzikës së këngëtares së talentuar LUCIBELA, që vjen nga Cabo-Verdean-e e São Nicolau, (një nga ishujt Barlavento). Ajo me vete ka sjellë ritmin dhe energjinë e pashterur ndërsa në kryqtetin kosovar do të këndojë në nderim të një artistje tjetër të madhe, Cesaria Evora-së. Kjo natë do të bëjë që të përjetohet performanca energjike dhe e natyrshme që vjen më shumë si përjetim i përbashkët i publikut me këngëtares.

First evening will be concluded with a concert and the beautiful sounds of the talented singer LUCIBELA, from São Nicolau (one of Barlavento islands), Cape Verde. She brings a never-ending rhythm and energy, and in the capital city of Kosovo, she will sing in tribute to another great artist, Cesaria Evora. This evening will be an experience of an energetic and natural performance that will be more of a joint experience of the public and singer.



Lucibela është një buzëqeshje; një erë e freskët që palos dhe dallgët e forta të valëve. Cabo-Verdean u lind në vitin 1986 në São Nicolau, një nga ishujt Barlavento - ishujt 'në drejtim të erës' në veri të arkipelagut të Sahelit. Tani ajo ka bërë albumin e saj të parë,

"Laço umbilical", që cilësohet si një kordon që lidhë këngëtares me tokën e saj. Mbi trembëdhjetë pjesë muzikor, Lucibela një zë i artë që prekë shumë ceshitje të shoqërisë: duke qenë një grua dhe një përfaqësues e Cabo-Verdean që jeton larg vendit dhe di të dashrujë me sensualitet dhe dhe mirësi. Sekreti i teknikës së jashtëzakonshme vokale të Lucibelas qëndron në aftësinë e saj për të eksploruar regjistrin e thellë të muzikës së valizmit samba të Brazilit, duke i shtuar asaj një vibrim emocionues.

Koncerti mbahet në nderim të artistes së madhe **Cesaria Evora**, një artiste nga Cape Verdean, e njohur si "**Diva e zbatthur**" pasi që performonte pa kepucë, ndërsa shpesh njihet edhe si "Mbretresha e Mornas". Ajo ka kënduar në koncerte të shumta dhe ka qenë fituese e disa çmimeve. Albumi i saj i realizuar në vitin 1995 i dha një sukses ndërkombëtar, duke bërë që ajo të nominohet për herë të parë për Grammy Award. Në vitin 1997, ajo fitoi në "KORA All African Music Awards" në tri kategori "Artistja më e mirë e Afrikës Perëndimore", "Albumi më i mirë" dhe "Merita e Jurisë". Në vitin 2003, albumi i saj "Voz d'Amor" u shpërblye me çmimin Grammy në "World music category".

Lucibela is a smile; a fresh breeze ruffling the bougainvillea blooms and waves. The young Cape Verdean was born in 1986 on São Nicolau, one of the Barlavento islands - the 'windward' isles to the north of the Sahel archipelago. She has already released her first album.

Laço umbilical, the cord that links the singer to her land. Over thirteen tracks, Lucibela, a golden voice, explores the issues involved: being a woman and a Cabo-Verdean representative, living far away and loving with sensuality and grace. The secret of Lucibelas extraordinary vocal technique lies in her ability to explore the deep register of Brazil's great samba music and dance, adding a vibrato to it.

The concert is held as a tribute to a great artist, Cesaria Evora, from Cape Verde, known as the "barefoot diva" because she performed shoeless. She was often known as "Mornas' Queen". She performed in many concerts and won several prizes. Her album released in 1995 gave her an international success and brought her first Grammy Award nomination. In 1997, at the "KORA All African Music Awards", she won in three categories: "Best West Africa Artist", "Best Album" and "The Jury's Merit". In 2003, her album "Voz d'Amor" received a Grammy Award in "World Music Category".

KONFERENCË- #EPATHYER / Vendi i gabuar, koha e gabuar - 20 vjet pas

CONFERENCE “#UNBROKEN / Wrong Place, Wrong Time - 20 Years Later”

📍 11.06.2019 – DITA E DYTË (E MARTË)

🕒 10:00 - 16:00

📅 HOTELI GRAND

Grand Hotel, vendi ku krimet ndaj grave kanë qenë pjesë e luftës në Kosovë, do të jetë nikoqire konferencës “#EPATHYER / Vendi i gabuar, koha e gabuar - 20 vjet pas”, që do të trajtojë temën e të mbijetuarave të dhunës seksuale, gjatë luftës në Kosovë.

Paneli I: “Të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës së viteve 90-ta në Kosovë – 20 vjet pas”

Panelistët: Paneli I:

Paneliste: Feride Rushiti - QKRMT/KS, Kadire Tahiraj - QPDG/KS, Reyes Charle Cuellar - Gender Adviser/EU, Sabiha Husić - Medica/BiH, Mirlinda Sada - Medica/KS;

Moderatore: Valdete Idrizi – Aktiviste e pages/KS.

Paneli II: S’ka Marre në Drejtësi: Adresimi i stigmës ndaj të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së viteve 90-ta në Kosovë – Perspektiva e institucioneve shtetërore”

Panelistët: Panelistë/e: Drita Hajdari – Prokurore/KS, Minire Begaj – Kryetare e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e personave të dhunuar gjatë luftës së Kosovës/KS, Tom Adams – zëvendësi i shefit të misionit / Ambasada Britaneze në Kosovo, Edi Gusia – Agjensia për Barazi Gjinore/KS; Moderator: Jeta Xharra - BIRN/KS.

Grand Hotel, the place where crimes against women were part of the war in Kosovo, will host the conference ‘#UNBROKEN / Wrong Place, Wrong Time - 20 Years Later’, that will address the war sexual violence survivors’ issue in Kosovo.

Panel I: “The Survivors of sexual violence during 90s war in Kosovo - 20 years later”

Panelists: Feride Rushiti - KRCT/KS, Kadire Tahiraj - QPDG/KS, Reyes Charle Cuellar - Gender Advisor/EU, Sabiha Husić - Medica/BiH, Mirlinda Sada - Medica/KS;

Moderator: Valdete Idrizi - peace activist/KS

Panel II: No shame in justice: Addressing Stigma against Survivors of Sexual Violence during the 90’s Kosovo War - Government Institutions Perspective

Panelists: Panelists: Drita Hajdari – Prosecutor/KS, Minire Begaj – Chairwoman of the Government Commission to Recognize and Verify Survivors of Sexual Violence during the Kosovo War /KS, Tom Adams – Deputy Chief Mission / British Embassy in Kosovo, Edi Gusia – Gender Equality Agency/KS; Moderator: Jeta Xharra - BIRN/KS.

Paneli III: “Luftimi i stigmës përmes Mediave dhe Artit – Adresimi dhe njohja dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”

Panelistët: Paneliste: Eliza Hoxha - artiste & aktiviste /KS, Ardianë Pajaziti - KutIPlus/KS, Ramize Murtezi-Shala - RTK/KS, Valerie Plesch – Fotoreportere e pavarur /USA

Moderatore: Donika Emini – Aktiviste – Huluntuese/KS

Panel III: Fighting stigma through Media and Arts - Acknowledging sexual violence during the war in Kosovo.

Panelists: Panelists: Eliza Hoxha - artist, activist/KS, Ardianë Pajaziti - KultPlus/KS, Ramize Murtezi Shala - RTK/KS, Valerie Plesch - Independent Photojournalist/USA

Moderator: Donika Emini - Activist - Researcher/KS



MASTERKLASË - GRATË NË WIKIPEDIA + EDIT-A-THON

MASTERCLASS - WIKIWOMEN + EDIT-A-THON

Kosovë/Kosovo, Shqipëri/Albania

📍 **11.06.2019 – DITA E DYTË/DAY TWO (E MARTË/TUESDAY)**

🕒 **11:00 – 16:30**

📍 **QENDRA PËR INOVACION NË KOSOVË (ICK) / INNOVATION CENTER KOSOVO (ICK)**

PUNËTORI/WORKSHOP

Trajneret/Facilitators: RINA ZHUBI / KS & ODETA DOÇI / SHQ

Wikipedia shpesh është adresa e parë që na njofton me historitë e grave që kanë lenë gjurmë në botë. Duke u mbështetur në këtë punëtori "WikiWoman" do të përfshijë një prezantim të projekteve që fokusohen në punën e grave dhe paraqitjen e tyre në Wikipedia ndërsa mbështetet nga gratë shqiptare në Wikipedia, që do të pasohet me një sesion të punëtorisë redaktuese. Kjo punëtori synon të përmirësojë përmbajtjen e Wikipedia-s në gjuhën shqipe mbi tema të rëndësishme për gratë, të cilat do të kenë qasje më të lehtë në çështjet të cilat zgjojnë interesimin e tyre.

Qëllimi i punëtorisë fokusohet në këto objektiva:

- Informimi i pjesëmarrësve për Wikipedia dhe procesi i redaktimit me bashkëpunëtorë.
- Promovimi i konceptit të informimit dhe bashkëpunimit të lirë në komunitet për rritjen e materialit arsimor i cili është falas për përdorim;
- Njoftimi i publikut me projektet e Wikipedia për gratë, të cilat mbështesin zhvillimin e punës së grave në Wikipedia;
 - Pasurimi i Wikipedia-s duke krijuar artikuj të rinj për gratë;
 - Nxjita e publikut për t'u bashkuar me Wikipedia duke kontribuar në këto projekte.
- Ky aktivitet do të mundësojë që përmes qasjes falas të internetit, publiku të ketë sa më shumë informacion për temat që lidhen me gratë. Aktiviteti do të përfshijë takime me individë të cilët i njohin këto tema, në mënyrë që të motivohet për të kontribuar në informacionin e përbashkët në Wikipedia.

Wikipedia is often the first address checked about histories of women that left their traces throughout the world. With that in mind, "WikiWoman" workshop will include a presentation of projects that focus on the women's work and their presentation in Wikipedia. It is supported by Albanian women in Wikipedia, and will be followed by a session of editorial workshop. This workshop aims to improve the content of Albanian Wikipedia on topics important to women, in order to provide better access to women on the issues of interest for them.

Its aim is to:

- Inform the public on Wikipedia and its collaborative editing process.
- Promote the concept of free information and cooperation in the community to increase the educational material which is free of charge.
- Familiarize the public with Wikipedia's projects for women, which support the development of women's work on Wikipedia;
 - Improve Wikipedia by writing new articles on women.
 - Encourage the public to join Wikipedia by contributing to these projects.
- This activity will enable us to increase the free online access on women's topics. Activity will include meeting individuals who have knowledge of these topics to urge them to contribute to the information shared on Wikipedia.

Rina Zhubi është një alumini i R.I.T Kosovo. Ajo beson se me dedikim, përkushtim dhe hulumtim të duhur, çdo detyrë mund të realizohet. Karriera e saj filloi në Marrëdhënie me Publikun, ku shumë shpejtë karakteri i saj kreativ, energjik dhe dëshira e për të mësuar e ka shtyer në eksplorimin dhe përvetësimin e mekanizmave të rinj në arrijtjen e audiencave masive, veçanërisht në botën digjitale. Duke studiuar dhe praktikuar aftësi të reja, ajo krijoi interes për shkrim dixhital, bloxhe, content marketing dhe media sociale. Rina udhëheq Eikimedianët e Gjuhës Shqipe duke shtyrë përpara kërkimin e vazhdueshëm të Ekipedia në koleksionimin e të gjitha njohurive njerëzore. Kontributi i saj veçohet me zbatimin e programeve, aktiviteteve dhe ngjarjeve të ndryshme që fuqizojnë dhe angazhojnë komunitetin shqiptar për të kontribuar dhe zhvilluar përmbajtje edukative nën një licencë të lirë.

Rina Zhubi is an R.I.T Kosovo alumni. She believes that with dedication, commitment, and proper research, every task can be put to an end. Her career started in Public Relations, and soon enough her creative, dynamic and eager to learn persona led her in exploring and acquiring new mechanisms in reaching mass audiences, particularly in the digital world. Researching and practicing new skills, she became akin with digital copywriting, blogging, content marketing and social media. Rina leads the Wikimedians of Albanian Language furthering Wikipedia's ongoing search in collecting the sum of all human knowledge. Her contribution is noted with the implementation of numerous programs, activities, and events which empower and engage the Albanian community to contribute and develop educational content under a free license.

Odeta Doçi ka studiuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Prej vitesh ajo vazhdon të ndjek të njëjtën rrugë, atë të ligjeve dhe të së drejtës. Për më shumë se 2 vite ajo është redaktore në Ekipedia, ku vazhdimisht kontribuon njohuritë e saja dhe ndihmon që Ekipedia Shqip të jetë më e besueshme dhe e plotë.

Përveç redaktimit, ajo është edhe vullnetare aktive te Eikimedianët e Gjuhës Shqipe, ku ndihmon në organizimin dhe implementimin e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme. Kontributi i saj veçohet në zhvillimin e Programit të Edukimit të Ekipedias në Shqipëri si dhe promovimin e projekteve feministe në Ekipedia si EikiEomen, EikiEomen in Red etj.

Odeta, vlerëson se eksperiencia e saj në Ekipedia e ka ndihmuar atë të përmirësojë vetveten, duke e lidhur me projekte dhe njerëz të rinj që kanë po aq pasion sa ajo për t'i vënë në dispozicion për të tjerët për të mësuar.

Odeta Doçi studied at the Faculty of Law, University of Tirana. For years she continues to follow the same path, that of justice and law. For more than 2 years she is an editor on Wikipedia, where she continuously contributes her knowledge, helping Wikipedia become more reliable and comprehensive.

In addition to editing, she is also an active volunteer in Wikimedians of Albanian Language, helping to organize and execute various activities and projects. Her contribution is highlighted in the development of the Wikipedia Education Program in Albania and the promotion of feminist projects on Wikipedia such as WikiWomen, WikiWomen in Red, etc.

Odeta emphasizes that her experience in Wikipedia helped her to improve herself by linking to projects and young people who are as passionate as she is in making their knowledge available for others to learn.

NATA E POEZISË & MUZIKËS - "POEZI PËR FUQI" / SHQIPËTARET NËPËR BOTË



📍 11.06.2019 – DITA E DYTË (E MARTË)

🕒 19:00 – 20:30

📅 MENZA "RAMIZ SADIKU"

Poetët: DONIKA DABISHEVCI (KOSOVË), FLUTURA AÇA (SHQIPËRI), ILIRE ZAJMI (KOSOVË), KLARA BUDA (FRANCË), NURIE EMRULLAI (MAQEDONIA VERIORE) DHE SIBEL HALIMI (KOSOVË)

Muzika: ALBULENA JASHARI,


Këngëtare; FARUK BANJSKA- KITARË

Moderatore: Ilire Zajmi

